



Prishtinë, 15/08/2016

## Komentet në Aplikacionin për Tarifa të NQ Termokos për sezonin 2016/2017

### Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të ngrohjes për NQ Termokos për sezonin 2016/2017; në këtë aspekt me dt. 1 korrik 2016 NQ Termokos i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifor për sezonin 2016/2017 dhe "Plani i zbatimit dhe orari". Në vijim, me 4 korrik NQ Termokos-it i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifor, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzoj për shqyrtimin tarifor. Me 25 korrik 2016 NQ Termokos ka dërguar përmes e-mailit aplikacionin tarifor me të dhënat dhe informatat e kërkuara. Në këtë dokument janë dhënë komente për përmbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përmbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër të aplikacionit. Komentet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do duheshin dorëzuar. Më tutje komentet elaborojnë në përgjithësi dhe japin udhëzime për korrektësinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, kërkohen korrigjimet e nevojshme, informata dhe shpjegime shtesë.

### Përmbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar në formë elektronike nga NQ Termokos me 25 Korrik 2016 përmban këto dokumente:

- 1) Paqyrat Rregulative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2016-2017:
  - a) Pasqyra A e asetëve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;
  - b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
  - c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
  - d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
  - e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).
- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2015 – e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale:
  - a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
  - b) Bilanci i gjendjes;
  - c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
  - d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.



3) Të dhënat dhe informatat tjera dhe dokumentet mbështetëse:

- a) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike;
- b) Lista e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
- c) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2016/2017;
- d) Planifikimet për faturimin e konsumatorëve bazuar në furnizimin / konsumin e matur;
- e) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga kogjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
- f) Të dhëna për faturimin e konsumatorëve bazuar në matjen e konsumit në sezonin e kaluar 2015/2016;

**Komente për Përmbajtjen e Aplikacionit të Tarifave**

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Termokos gjer në një masë është i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Megjithatë janë vërejtur disa mangësi kryesisht sa i përket detajzimeve dhe shpjegimeve shtesë për të dhënat kryesore dhe dokumenteve mbështetëse, që mund të përmbliidhen si në vijim:

- Detajet për parashikimet e prodhimit të energjisë termike si: kapacitetet e angazhuara, sasi të energjisë termike dhe humbjet përkatëse në rrjet;
- Të dhënat e detajuara teknike dhe përshkrimet kryesore të projekteve investive / zhvillimore;
- Të dhënat për regjistrimin e leximit të matjeve të furnizimit në nënstacione termike (në të gjithë nënstacionet ku ekzistojnë matësat funksional);
- zberthimet e detajuara (shpalosjet) dhe shpjegimet përkatëse për komponentet kryesore të Pasqyrave rregullative të parashikuara;

**Komentet për secilin dokument të dorëzuar në ZRRE**

- 1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2016-2017:

Fillimisht duhet theksuar se në të gjitha pasqyrat rregullative keni shënuar periudhën e raportimit 15 tetor – 15 prill. Sipas kërkesave tona parashikimet duhet të përfshijnë periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin e plotë të ngrohjes – pra në këtë rast 15 tetor 2016 – 14 tetor 2017. Ne e kuptojmë faktin se për shkak të natyrës së shërbimit pjesa më e madhe e kostove krijohen gjatë sezonit të ngrohjes por sidoqoftë, duke qenë se NQ Termokos operon gjatë tërë vitit parashikimet duhet përfshirë tërë periudhën njëvjeçare.

- a) Pasqyra 'A' e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;

Në pasqyrën A janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Gjithashtu asetet janë paraqitur të ndara sipas aktiviteteve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta. Vlera neto kontabël e parashikuar është 40,827,339 € që paraqet



një rritje prej 6,607,934 € në krahasim me vlerën e asetëve në qershor 2016 (34,219,405 €). Kjo rritje përafërsisht përputhet me vlerën e investimeve të planifikuara për periudhën në fjalë (6,743,640€). Pra mund të konkludohet se Pasqyra A është plotësuar në mënyrë të rregullt dhe parashikimi i të dhënave është mjaft real.

Megjithatë, kjo pasqyrë nuk është shoqëruar me detaje mbi llogaritjen e pozicioneve kryesore, e sidomos janë të nevojshme detajet për llogaritjen e zhvlerësimit.

b) Pasqyra 'B' e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot.

- Nuk është dhënë kostoja e prodhimit të energjisë termike në ngrohtoren e NQ Termokos, respektivisht kostoja e lëndës djegëse – mazutit. Pa marrë parasysh se stabilimentet e ngrohtores është paraparë të shfrytëzohen vetëm në rast të ndaljeve / defekteve në TC Kosova B, ju duhet të parashikoni sasinë e lëndës djegëse – mazutit për një periudhë të arsyeshme, si dhe çmimin për ton që do rezultonte me koston e mazutit për prodhimin e energjisë termike në ngrohtore. Megjithëse në Pasqyrën 'E' ju keni paraparë sasinë e mazutit prej 1,000 ton dhe sasinë e prodhimit të energjisë termike në ngrohtore prej 10,170 MWh, ju nuk e keni paraqitur koston përkatëse.
- Për koston e energjisë termike nga kogjenerimi është paraqitur shuma prej 1,134,263 €, e cila paraqet një rritje prej rreth 46,000 € në krahasim me sezonin e kaluar, që konsiderohet një rritje e arsyeshme për shkak të rritjes së planifikuar të sipërfaqes ngrohëse. Megjithatë, ju duhet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje; këto detaje duhet dhënë ndarazi për komponentën e kapacitetit bazuar në rezervimin e kapaciteteve sipas Bilancit të energjisë, dhe komponentën e sasisë së energjisë termike duke u bazuar në konsumin e parashikuar. Normalisht për këto llogaritje duhet marrë për bazë tarifat e energjisë elektrike në fuqi, ashtu siç përshkruhet në Shtojcën 4 të Marrëveshjes për furnizimin me energji termike KEK – NQ Termokos.
- Për koston e elektricitetit është paraqitur kostoja prej 550,000 €, e që paraqet një rritje të dukshme prej rreth 125,000 € në krahasim me koston e realizuar sezonin e kaluar (425,000 €). Duke qenë se kjo paraqet një rritje të konsiderueshme është e nevojshme të ofroni arsyetimin dhe shpjegimin për një rritje të tillë.
- Kostoja e personelit në vlerë totale prej 788,193 € gjithashtu paraqet një rritje prej rreth 108,000 € në krahasim me koston e personelit të realizuar për sezonin e kaluar. Lidhur me koston e personelit fillimisht duhet të paraqesim rezervat tona lidhur me periudhën e raportimit, sepse ka një mospërputhje të konsiderueshme në mes të vlerës së kësaj kostoje në Pasqyrat Rregullative dhe në Pasqyrat financiare statutore për vitin kalendarik 2015 (1,241,140 €). Sidoqoftë nevojitet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje duke dhënë numrin e punëtorëve, pagën mesatare dhe elemente tjera të koston së personelit, si p.sh. kontributet / taksat etj. Po ashtu duhet dhënë arsyetimet përkatëse për rritjen e parashikuar.
- Nën pozicionin "Shpenzimet e shitjes dhe tjera administrative" është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 700,000 €, dhe nuk është dhënë ndonjë detajizim se cilat nënkomponentë e përmbajnë këtë pozicion. Në sezonin e kaluar ky pozicion ka qenë 529,771 €, ku pjesa kryesore i ka takuar nënkomponentës "shpenzimet e provizioneve të llogarive



të arkëtueshme<sup>1</sup> në vlerë prej 458,263 €. Lidhur me këtë dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni se, në përputhje me dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE e përcakton / lejon një përqindje të arsyeshme të nivelit të borxheve të këqija.

c) Pasqyra 'C' e Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin

- Nga analiza e jonë është vërejtur se, sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është rritur për 102,467 m<sup>2</sup> nga sezoni i kaluar. Mirëpo kjo shifër është rreth dyfish më e madhe se sa planifikimet e kyçjeve të reja që ju i keni deklaruar sipërfaqen prej 45,865 m<sup>2</sup>. Ne supozojmë se në këtë rritje të sipërfaqes ngrohëse merr pjesë edhe ri-aktivizimi i një numri konsumatorë të ashtuquajtur pasiv. Ju lutem të ofroni shpjegime dhe detaje të llogaritjes së sipërfaqes ngrohëse të parashikuar.
- Në përputhje me rritjen e parashikuar të sipërfaqes ngrohëse, në mënyrë të drejtë keni paraparë edhe rritjen e faturimit dhe të nivelit të arkëtimit. Parashikimet për rritjen e arkëtimit nga 45.6 % sezonin e kaluar në 60% për konsumatorët shtëpiak, dhe rritjen e nivelit të arkëtimit nga 81.7% në 85% për konsumatorët komercial e institucional janë mjaft realiste dhe të arritshme nëse vazhdohet me përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ngrohje por edhe me përpjekje të shtuara të arkëtimit efikas.

d) Pasqyra 'D' e shpenzimeve investive – investimet kapitale të planifikuara

Investimet e planifikuara të paraqitura nga ju janë shoqëruar me shpjegimet përkatëse për mënyrën e financimit, ku vërehet se pjesa dërmuese e investimeve planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare (KfW dhe Komisioni Evropian) me një pjesëmarrje të vogël të vetëfinancimit nga ndërmarrja. Shpjegimet shoqëruar nuk përmbajnë detaje tjera të projekteve investive të paraqitura. Me qëllim të përcaktimit sa më real të Bazës së Rregulluar të aseteve nevojitet një përshkrim i shkurtër i projekteve investive / zhvillimore, ku do paraqiteshin komponentët kryesorë të projekteve, si dhe planin e realizimit të tyre.

e) Pasqyra teknike 'E' – të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve.

Përgjithësisht të dhënat e paraqitura në këtë pasqyrë mund të vlerësohen si parashikime reale dhe të bazuara. Mirëpo gjatë analizës sonë janë vërejtur dy gabime në llogaritje: i) Nën pozicionin '11': Prodhimi neto i energjisë termike ju keni llogaritur vlerën prej 255,865 MWh – ne mendojmë se vlera korrekte është: 254,735 MWh; ky gabim mandej është reflektuar edhe në pozicionet '13-16'. ii) Pozicionet '20' Orët e ngarkesës së plotë dhe '21' Kërkesa për ngrohje janë gabimisht të llogaritura – vlerë të rritura tej mase. Ju lutem që të bëni korrigjimet përkatëse

---

<sup>1</sup> Në Pasqyrat financiare statutorë për vitin 2015 në Raportin e auditimit kjo nën-komponentë paraqitet në të njëjtën vlerë por me emëtimin "Lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta"



## 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2015

Pasqyrat financiare statutores për vitin 2015: “Pasqyra e pozitës financiare”, “Pasqyra e të hyrave gjithpërfshirëse”, “Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet”, janë të përfshira në Raportin e auditorëve të pavarur dhe të aprovuara nga menaxhmenti i ndërmarrjes dhe të nënshkruara nga zyrtarët kompetentë. Nuk ka ndonjë koment tjetër shtesë.

## 3) Dokumentet tjera mbështetëse:

- a) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike;

Lista e nënstacioneve përmban të dhëna mjaft detale për sipërfaqet ngrohëse të kyçura në secilin nënstacion, kapacitetet përkatëse, statusi (aktiv respektivisht pasiv) dhe të dhënat teknike, si dhe është e dhënë ndarja sipas rajoneve dhe ndarja sipas grupeve të konsumatorëve. Gjatë analizimit të kësaj liste është vërejtur një mospërputhje në sipërfaqen ngrohëse në krahasim me të dhënat e paraqitura në Pasqyrat ‘C’ dhe ‘E’. Në fakt totali i sipërfaqes ngrohëse i paraqitur në listën e nënstacioneve është 1,325,829 m<sup>2</sup> ndërsa në pasqyrat ‘C’ dhe ‘E’ është 1,221,480 m<sup>2</sup> – pra afërsisht një ndryshim prej rreth 100 mijë m<sup>2</sup>. Duke supozuar se këtu janë përfshirë edhe konsumatorët pasiv, ne kemi vlerësuar sipërfaqen e konsumatorëve me status pasiv mirëpo në grupimin “rezidencial” është vetëm një nënstacion i kategorizuar “pasiv” me sipërfaqe 7,569 m<sup>2</sup>. Gjithashtu në fund të listës nën grupin “institucional” janë paraqitur një numër i nënstacioneve “pasive” në sipërfaqe prej 23,456 m<sup>2</sup> por që nuk i kanë të paraqitura sipërfaqes ngrohëse. Pra në total janë rreth 31 mijë m<sup>2</sup> sipërfaqe e kategorizuar ‘pasiv’. Ju lutem të ofroni shpjegimet gjegjësisht sqarimet përkatëse për këtë mospërputhje si dhe të bëni korrigjimet e duhura.

- b) Lista e asetëve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e asetëve

Lista e asetëve ofron një pasqyrë gjithpërfshirëse dhe mjaft detale të asetëve fikse, ku janë dhënë të gjitha asetet me përshkrim të shkurtër (emërtim), datat e blerjes, vlerat fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël pas zbritjes së zhvlerësimit të akumuluar). Gjithashtu asetet janë të grupuara sipas departamenteve të ndërmarrjes.

Vërejtja kryesore ka të bëjë me asetet nga projekti i kogjenerimit të cilat janë regjistruar si total në vlerë 28,198,580 € – pa ndarje në kategoritë e zakonshme të asetëve - dhe janë vendosur nën grupin “NQ Termokos. Këto asetet nevojitet të kategorizohen në kategoritë e zakonshme si p.sh. stabilimentet e pajisjet, tubacionet dhe fittingu i rrejtit, etj. Përafërsisht e njëjta vërejtje është dhënë edhe në Raportin e Auditorëve të pavarur (“Bazat për opinion të kualifikuar” pika ‘1’).

Gjithashtu asetet e projekteve investive të rehabilitimit të rrjetit dhe nënstacioneve janë regjistruar si “investime në vijim” në vlerë totale 4,133,033 € dhe janë vendosur nën grupin “NQ Termokos”. Lidhur me këtë fillimisht duhet theksuar se, sipas praktikave rregullative asetet pranohen në Bazën e rregulluar të asetëve kur të realizohen dhe futen në operim. Për



informimin tuaj këto mund të përfshihen në Bazën e rregulluar të aseteve si investime të reja.

Duke qenë se lista e aseteve shërben si bazë për përcaktimin e Bazës së Rregulluar të aseteve komentet e lartë përmendura duhet adresuar nga ju.

c) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2016/2017

Të dhëna mjaft detale të paraqitura në formë tabelare – nuk ka komente.

d) Planifikimet për faturimin e konsumatorëve bazuar në furnizimin / konsumin e matur

Përveq të dhënave për sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin, në këtë tabelë, për disa objekte / konsumatorë janë paraqitur janë dhënë edhe shifrat e matësve të energjisë termike dhe regjistrimet e matjeve të konsumit, ndërsa për të tjerët këto të dhëna nuk ekzistojnë (shifra e matësit dhe regjistrimet e konsumit). Ju lutem të jepni shpjegime nëse këto objekte /nënstacione aktualisht posedojnë matës të energjisë termike.

e) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga kogjenerimi;

Nuk ka komente

f) Të dhëna për faturimin e konsumatorëve bazuar në matjen e konsumit në sezonin e kaluar 2015/2016

Nuk ka komente

Shënim:

Këto komente janë dhënë me qëllim të korrigjimit dhe kompletimit të aplikacionit për tarifa në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura aty.

Përgatitur nga:

Departamenti i Energjisë Termike dhe Gazit (DETG)